VENDIM
Nr.90, datë 17.3.2011

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR HETIMIN E DREJTIMIT DHE VEPRIMTARISË SË ORGANEVE DREJTUESE DHE SHËRBIMEVE TË KUVENDIT PËR PERIUDHËN SHTATOR 2005 - DHJETOR 2010

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 8 e 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin edhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet komisioni hetimor i Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për të hetuar veprimtarinë e administratës dhe organeve drejtuese të Kuvendit, më konkretisht Byronë e Kuvendit, Sekretariatin për Buxhetin dhe Shërbimet e Kuvendit për zbatimin e legjislacionit që rregullon funksionimin e Kuvendit dhe statusin e deputetit për periudhën shtator 2005 - dhjetor 2010.

II. Objekti i punës së komisionit hetimor është:

a) hetimi i veprimtarisë së organeve drejtuese të sipërcituara, për sa u përket detyrimeve që lindin nga zbatimi i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë;

b) hetimi i veprimtarisë së administratës së shërbimeve të Kuvendit, sipas kompetencave të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit, ligjin për buxhetin, legjislacionin që rregullon statusin e deputetit dhe legjislacionin për ekzekutimin e buxhetit;

c) hetimi i Byrosë dhe administratës së Kuvendit, në lidhje me përcaktimin e strukturës dhe organikës së administratës ndihmëse të Kuvendit dhe zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil apo atij të punës në rekrutimin, transferimin apo ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së personelit të administratës;

ç) hetimi i procedurave të vlerësimit dhe tjetërsimit të mjeteve të transportit në pronësi të Kuvendit dhe pasojat financiare që ato kanë sjellë në Buxhetin e Shtetit;

d) hetimi i funksionimit të stafit ndihmës të Kuvendit, puna që ata kryejnë dhe shpërndarja e punës mes komisioneve, zbatimi i kërkesave ligjore për respektimin e procedurave në shqyrtimin e projektligjeve, si dhe në emërimet e Kuvendit në institucionet dhe entet në varësi të tij;

dh) hetimi i integritetit dhe efiçensës së sistemit të votimit elektronik në Kuvend;

e) propozimi i ndryshimeve të nevojshme legjislative dhe organizative, me qëllim korrigjimin e mangësive të konstatuara, duke synuar mirëfunksionimin e Kuvendit dhe shërbimeve të tij:

III. Komisioni hetimor parlamentar përbëhet nga 11 deputetë, nga të cilët 5 i përkasin pakicës dhe 6 shumicës parlamentare. Kryetari i komisionit i përket Partisë Socialiste.

Përbërja e komisionit është si më poshtë:

1. Ilir Beqja	
2. Damian Gjiknuri	
3. Erion Braçe	
4. Ermonela Felaj	
5. Arben Isaraj	
6. Jemin Gjana	zëvendëskryetar
7. Edi Paloka	anëtar
8. Paulina Hoti	"
9. Arenca Trashani	"
10. Edmond Spaho	"
11. Fatos Beja	"

IV. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 4-mujor nga miratimi i këtij vendimi.

V. Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të këtij komisioni.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE